

DIFERENCAT MIDIS BURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE VROJTIMEVE

RASTI I TREGUESVE TË PUNËSIMIT DHE PAGËS MESATARE

REZARTA MYRTOLLARI, INSTITUTI I STATISTIKAVE
rmyrtollari@instat.gov.al

Hyrje

Në prodhimin e statistikave zyrtare, për një fenomen të caktuar, të dhënat në dispozicion mund të vijnë nga vrojtimet statistikore dhe burimet administrative. Në ditët e sotme, kombinimi i këtyre dy burimeve është një strategji premtuese dhe me risi, i cili ndikon në cilësinë dhe sasinë e kërkimeve dhe rrit potencialin e të dhënave (Künn, 2015). Megjithatë, kjo lidhje shpesh shoqërohet me sfida serioze, nisur nga fakti i thjeshtë se qëllimi i ndërtimit të dy burimeve është i ndryshëm. Të dhënat administrative përkufizohen si sete të dhënash të mbledhura nga institucione apo agjenci qeveritare për qëllime të administrimit të taksave, përfitimeve apo shërbimeve publike (UNECE, 2011). Nga ana tjetër, të dhënat nga vrojtimet janë të mbledhura posaçërisht për qëllime statistikore. Ky artikull ekzaminon diferencat midis burimeve administrative dhe vrojtimeve, duke u përqendruar specifiku në variablat e përbashkëta të listëpagesës si burim administrativ dhe atyre nga vrojtimet e kryera në INSTAT.

Sipas Penneck (2007) vrojtimet ndryshojnë nga të dhënat administrative, në kuptimin që ato janë të ndërtuara në mënyrë specifike për qëllime analitike, kështu që mbulimi i popullsisë, përkufizimet, metodologjia dhe koha mund të dizajnohen për të përmbushur këto nevoja analitike. Megjithatë, madhësia e kampionit mund të jetë e vogël - vrojtimet në shkallë të gjerë janë të shtrenjta dhe vrojtimet në shkallë të vogël kanë përdorim të kufizuar për analizimin e popullatave të vogla ose zonave lokale. Kampionet janë subjekte të gabimeve

(sample-errors) dhe të mos-përgjigjeve (non-response bias). Përveç kësaj, nuk mund të jemi të sigurt për saktësinë e përgjigjeve të anketës së biznesit, krahasuar, për shembull, me të dhënat administrative të mbledhura për qëllime tatimore. Sistemet administrative, gjithashtu, kërkojnë të dhëna nga individët, por këta të fundit shpesh e shohin këtë si një pjesë të domosdoshme të procesit administrativ, sesa si një barrë shtesë statistikore. Seksionet në vijim do të shqyrtojnë disa prej këtyre çështjeve në detaje, bazuar mbi punimin e Johnson dhe Moore (2008) të trajtuara nga ana teorike dhe duke i ilustruar me shembuj konkretë nga rasti i vlerësimit të treguesit të pagës mesatare dhe punësimit nga dy burime të ndryshme në INSTAT.

1. ÇËSHTJET E MBULIMIT TË POPULLATËS

Popullata e mbuluar nga një sistem i regjistrimeve administrative është e përcaktuar përmes legjislationit, në bazë të fushëveprimit të programit që ka për qëllim regjistrimet. Shpesh kjo popullatë kufizohet në bazë të karakteristikave specifike demografike ose ekonomike. Në disa raste, individët mund të kenë nevojë të ndërmarrin disa veprime për t'u bërë pjesë e sistemit administrativ (për shembull regjistrimi i fermerëve në sistemin e tatimeve dhe të sigurimeve shoqërore përmes pajisjes me NIPT¹ për të përfituar nga skemat mbështetëse të qeverisë apo marrjen e kredive). Prandaj është e rëndësishme të shqyrtohet se çfarë i nxit njësitë individuale që të regjistrohen. Mund të ketë faktorë favorizues për disa individë për të shmangur regjistrimin, veçanërisht nëse rrethanat e tyre i vendosin afër një pragu që kërkon pjesëmarrje të detyrueshme apo shoqërohet me kosto financiare, si për shembull vendosja e një page minimale mbi të cilën llogariten kontributet. Një tjetër faktor është ndryshimi i politikave, i cili mund të luhatë popullatën e marrë në studim nga viti në vit.

Njësia e studimit e nevojshme për qëllime statistikore shpesh përqendrohet në karakteristika të grupeve të formuara nga njësitë (ndërmarrje që operojnë në një aktivitet të caktuar ose ndërmarrje që konsiderohen të mëdha), kurse të dhënat administrative përqendrohen në identifikimin e njësive specifike në mënyrë që, bazuar mbi karakteristikat e tyre individuale (për shembull të punësuar me kohë të plotë, të dypunësuar etj.) të ndërmerren veprime të caktuara. Kështu që, dallimet në njësinë ekonomike, të raportuar në deklaratat e të ardhurave tatimore, kufizojnë dobinë e të dhënave për disa lloje të kërkimeve.

Popullata e synuar nga një vrojtim përcaktohet nga qëllimi i studimit, disponueshmëria e një popullate (sampling frame) dhe kostoja e kampionit. Popullata, për shumicën e vrojtimit, rrjedh nga burimet ekzistuese, siç janë të dhënat e popullsisë bazuar në gjeografi, listat e adresave ose burimet administrative. Shpesh, një nga çështjet më të vështira në dizajnimin e një vrojtimi, është pikërisht gjetja e një popullate të përshtatshme (Lessler dhe Kalsbeek, 1992). Përzgjedhja e popullatës së gabuar për marrjen e kampionit mund të çojë në probleme të nën-mbulimit dhe mund të ndikojë rezultatet e marra nga të dhënat e vrojtimit. Një problem tjetër ngrihet nëse një vrojtim synon një popullsi që është e vështirë për t'u gjetur ose

matur. Direkt e lidhur me disponueshmërinë e një popullate është kostoja potenciale e marrjes së të dhënave të popullatës dhe kostoja e intervistimit të një kampioni në madhësinë e dëshiruar. Për popullatat e synuara, që janë të vështira për t'u gjetur, thjesht kostoja e rritjes së madhësisë së kampionit për të siguruar mbulim më të mirë mund të jetë penguese për të ndërmarrë një nismë të tillë.

2. ÇËSHTJET E PËRMBAJTJES

Objekti për të cilin janë mbledhur të dhënat administrative mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në dobinë e tyre për qëllime statistikore në lidhje me sasinë e të dhënave në dispozicion, përkufizimet e të dhënave, konsistencën ndërmjet periudhave të ndryshme kohore dhe cilësinë e të dhënave. Shumë herë dobia e sistemeve të regjistrave administrative është e kufizuar sepse mbledhjen vetëm ato variabla që nevojiten për të administruar programin e pagesave të tatimit dhe taksave. Këto variabla mund të jenë vetëm një pjesë e vogël e të dhënave të raportuara në një formë administrative. Përveç kësaj, për shkak se kërkesat e programit përcaktohen nga legjislationi, konceptet dhe përkufizimet e variablave të përdorur për të përmbushur nevojat e programit, nuk përputhen domosdoshmërisht me ato që kërkohen për analiza sociale ose ekonomike (Brackstone, 1987). Për shembull, disa nga problemet që hasen tek të dhënat nga burimet administrative lidhen me faktin që në vendin tonë nuk përdoret koncepti i orëve të punës, por ditët e punës, çka e bën të vështirë krahasimin e të dhënave të punësimit dhe të llogarive kombëtare. Faktorë të tillë mund të paraqesin kufizime serioze për dobinë e përgjithshme të sistemeve të të dhënave administrative ose mund të kërkojnë që agjencia administrative të ndërmarrë mbledhjen dhe/ose redaktimin e të dhënave shpesh, duke shkaktuar kosto financiare dhe duke vonuar disponueshmërinë e të dhënave.

Një aspekt i rëndësishëm i përmbajtjes së të dhënave është vazhdimësia me kalimin e kohës, si në variablat e përfshirë, ashtu edhe në përkufizimet e tyre. Mbulimi dhe përmbajtja në sistemet e të dhënave administrative mund të jenë subjekt i ndërprerjeve që rezultojnë nga ndryshimet në ligje, rregullore, praktikave administrative ose fushëveprimi i programit (Brackstone, 1987). Për shembull, rishikimet e ligjit mbi nivelin e pagës minimale dhe maksimale bënë që paga bazë minimale mujore për punonjësit, në shkallë vendi, e detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo person juridik apo fizik, vendas apo i huaj, është 24.000

1 Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm

lekë nga 22.000 lekë që ishte para kësaj periudhe. Ndryshime të tilla kanë ndikim të rëndësishëm në përdorimet statistikore të të dhënave për krahasimet midis periudhave.

Cilësia e të dhënave mund të jetë gjithashtu një shqetësim në sistemet e të dhënave administrative. Informacioni që mund të jetë statistikisht i rëndësishëm, por më pak i rëndësishëm për qëllime administrative, shpesh raportohet, kontrollohet dhe përpunohet në mënyrë të papërsosur. Të tillë mund të përmendim zgjedhjen e profesionit nga personi i cili bën deklarinë e pagës. Variabli që tregon kategorinë e profesionit ka një rëndësi dytësore për agjencitë administrative, për sa kohë që personi paguan rregullisht kontributet. Nga ana tjetër, mund të përmendim që ky variabël merr një rëndësi të veçantë për prodhimin e statistikave rreth pagës mesatare sipas grup-profesioneve. Variablat e të dhënave, të përdorura kryesisht si informacion dytësor, mund të jenë me cilësi të ulët ose madje jo të plota (si në rastin e ditëve të punës për të cilat plotësimi është zakonisht standard prej 21 ose 22 ditë pune). Ky fenomen, gjithashtu, mund të ndodhë me të dhënat që grumbullohen specifikisht për qëllime statistikore, duke përdorur kanalet ekzistuese administrative, si në rastin e klasifikimit të aktivitetit të ndërmarrjeve në NVE Rev.², i mbledhur nga agjencitë administrative, për llogari të INSTAT. Këto variabla mund të jenë me cilësi më të ulët nëse prioriteti i tyre nuk është shumë i lartë për autoritetin administrues ose për subjektin që jep informacionin (Jensen, 1987). Së fundmi, besueshmëria e të dhënave mund të ndikohet edhe nëse informacioni i dhënë nga subjekti tatimor mund të përdoret për të shkaktuar fitime ose humbje për subjektin. Për më tepër, duke qenë se të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara për qëllime administrative përgjithësisht u jepet prioritet mbi ato që kërkohen për qëllime statistikore, sasia e përpunimit të kërkuar për të dhënë të dhëna administrative të përshtatshme për qëllime statistikore mund të ndikojë në kohën që këto të fundit u vihen në dispozicion statistikienëve.

Shumë prej çështjeve të ngritura më lart janë më së miri të adresuara dhe zgjidhura përmes vrojtimeve. Sidoqoftë, në të dhënat e vrojtimit shfaqen disa çështje përmbajtjeje dhe vlerësimi të një lloji tjetër. Një çështje kyçe është natyra vullnetare e përgjigjeve ndaj vrojtimeve kundrejt pjesëmarrjes me mandat ligjor në shumicën e programeve të të dhënave administrative. Në shumicën e vrojtimeve intervistuesit (personalisht ose nëpërmjet telefonit) përpigjen të bindin të anketuarit që vullnetarisht të japin kohën e tyre

dhe informacion, edhe pse nuk ka pasoja kur ai refuzon apo ndonjë përfthimi të drejtpërdrejtë nëse pranon të përgjigjet. Nëse një i anketuar pajtohet të marrë pjesë në vrojtimit, është ende e mundur që ky i fundit të refuzojë t'i përgjigjet pyetjeve në mënyrë "të vërtetë".

Për të intervistuarit, të cilët pajtohen të marrin pjesë dhe t'i përgjigjen të gjitha pyetjeve të anketës, gabimi i matjes është ende një shqetësim për të dhënat e vrojtimit. Të anketuarit mund të "mendojnë" përgjigjet ndaj pyetjeve; edhe nëse supozimet e të anketuarve në përgjithësi janë të paanshëm, një përafrim i tillë zvogëlon efikasitetin e vlerësimit të të dhënave. Të anketuarit mund të kenë, gjithashtu, vështirësi për të kujtuar ngjarjet e kaluara. Gabime të tjera tipike të matjes përfshijnë rrumbullakimin e shumëve, keqkuptimin e pyetjeve dhe ndryshimin e përgjigjeve për shkak të frikës lidhur me të dhënat e deklaruara ose dëshirës për të mbrojtur privatësinë. Hulumtime të shumta ekzistojnë lidhur me gabimet e matjeve dhe efektet e tyre në të dhënat e vrojtimit (Lessler dhe Kalsbeek, 1992). Ndërsa është e vërtetë që për të dhënat administrative mospërgjigjia nuk është një problem thelbësor, nuk është e qartë nëse të dhënat administrative janë gjithmonë më të sakta sesa të dhënat e vrojtimit. Një shembull është numri i punonjësve që deklaroi ndërmarrja; disa ndërmarrje me dashje mund të paraqesin gabimisht numër punonjësish më të ulët në deklaratat tatimore për të zvogëluar detyrimet e tyre tatimore. Të njëjtët individë mund të raportojnë vlerën e vërtetë në përgjigje të një pyetësi pasi nuk ka pasoja ligjore nëse thuhet vlera e vërtetë. Një tjetër çështje e përmbajtjes për të dhënat e vrojtimit është afati kohor i të dhënave. Ndërsa shumë vrojtimit të thjeshta kryhen me frekuencë të shpeshtë, të tilla si mujore apo tremujore, shumica e vrojtimeve më komplekse ndodhin çdo vit ose edhe më rrallë. Kostot dhe kufizimet e tjera të burimeve janë faktorë kryesorë në përdorimin në kohën e duhur të të dhënave të vrojtimit. Një çështje përfundimtare e përmbajtjes për të dhënat e vrojtimit është validimi i të dhënave. Ndonjëherë është e mundur që të kryhen studime për validimin pasi një vrojtimit të ketë përfunduar dhe këto studime të shtojnë kosto të tjera për vrojtimit ose validimi i variablave të zgjedhur të të dhënave mund të kryhet me burime të jashtme, siç janë censet ose të dhënat administrative, por shpesh nuk ekziston asnjë burim për validim.

2 Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev.2

3. ÇËSH TJET E PRIVATËSISË

Çdo përdorim i të dhënave administrative për qëllime kërkimore duhet të marrë parasysh ligjet që mbrojnë privatësinë e të dhënave. Hulmimi i të dhënave administrative shpesh është i kufizuar në përdorime brenda fushës së veprimit të një misioni të agjencisë dhe duhet të kryhet nga personat që punojnë për agjencinë si punonjës, kontraktorë ose sipas Memorandumeve të Bashkëpunimit që lejojnë punonjësit e institucioneve të ndryshme të shkëmbejnë të dhëna. Perceptimet e publikut për mbrojtjen e privatësisë janë shumë të rëndësishme, për ruajtjen e vullnetit të mirë të kërkuar për të mbajtur nivelet e deklarimeve. Shpesh, për shkak të këtyre faktorëve, të dhënat e vendosura në dispozicion janë të zhveshura nga faktorët identifikues. Për shembull, në rastin e të dhënave individuale nga burimi administrativ mungojnë variablat e identifikimit të drejtpërdrejtë, disponueshmëria e të cilave mund të sillte në një përdorim statistikor më të gjerë dhe për një kombinim të të dhënave nga burimet e ndryshme. Megjithatë konfidencialiteti i të dhënave është me rëndësi të madhe për suksesin e tanishëm dhe të ardhshëm të çdo vrojtimi dhe regjistrimi administrativ. Nëse subjektet nuk besojnë se të dhënat e tyre janë të mbrojtura mjaftueshëm, normat e përgjigjes dhe cilësia e përgjithshme e të dhënave do të pësojnë deformime. Ligjet e konfidencialitetit dhe privatësisë ofrojnë mbrojtje të rëndësishme kundër abuzimit të mundshëm të të dhënave.

4. TË DHËNAT E PUNËSIMIT DHE PAGAVE

Dy burimet, ai administrativ dhe anketat (si Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve, ATN), japin informacion të rëndësishëm me frekuencë tremujore lidhur me numrin e punonjësve dhe fondin e pagave, tregues të cilët përdoren për llogaritjen e pagës mesatare dhe të indekseve të numrit mesatar të të punësuarve dhe fondit të pagës. Të dhënat administrative kanë një informacion më të zgjeruar demografik lidhur me individin dhe të dhënat numerike mbi kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Nga ana tjetër, të dhënat nga anketat janë më të limituara duke përfshirë vetëm numrin e punonjësve dhe fondin e pagave të ndërmarrjes që anketohet.

Ndryshimet më të rëndësishme midis dy burimeve, ashtu si u trajtuan në parim edhe më lart, lidhen me njësinë e vrojtimit, mbulimin e popullsisë dhe madhësinë e kampionit. ATN-ja është një vrojtimit me frekuencë tremujore, e cila ka ndërmarrjen si

njësi studimi, ku variablat kryesore të kërkuar janë Shitjet neto (xhiro), Prodhimi Industrial, Prodhimi në ndërtim, Numri mesatar i të punësuarve, Fondi i pagave, Çmimet e Prodhimit, Çmimet e Importit, Kosto në Ndërtim (INSTAT, 2017). Të gjithë treguesit e prodhuar janë të shprehur në indekse, në ndryshim vjetor dhe tremujor. Njësinë e studimit në burimin administrativ është gjithmonë individi dhe treguesit e pagës mesatare shprehen si vlera absolute. Madhësia e kampionit të ATN-së është e kufizuar për shkak të frekuencës dhe kostos, dhe anketa nuk mbulon të gjitha aktivitetet ekonomike duke lënë jashtë vlerësimin e aktivitetet bujqësore (seksioni A), ato financiare dhe të sigurimeve (seksioni K), të pasurive të paluajtshme (seksioni L), administratës publike (seksioni O), arsimit dhe shëndetësisë (seksionet P dhe Q), si dhe aktivitetet e artit, argëtim dhe zbavitje, shërbime të tjera dhe aktivitete të organizmave ndërkombëtare (përkatesisht seksionet R, S, T, U), të cilat janë jashtë fushës së saj të mbulimit, çka do të thotë që informacioni me bazë tremujore, nga vrojtimit mbi punonjësit dhe pagat, mungojnë për këto industri. Nga ana tjetër, informacioni nga burimi administrativ përfshin individët dhe ndërmarrjet në të gjitha aktivitetet e ekonomisë.

Ndryshimi në metodologji ka një ndikim të drejtpërdrejtë në vlerësimet e nxjerra nga secili burim. Për më tepër, vlerësimet e ATN-së nuk janë veçanërisht të përqendruara në nxjerrjen e pagës mesatare dhe mungesa e një informacioni të detajuar mbi punonjësit (për shembull i punësuar me kohë të plotë apo të pjesshme, i dypunësuar, kategoria e kontributeve etj.) e bën të pamundur aplikimin e një metodologjie të njëjtë si ajo e përdorur për vlerësimin e pagës mesatare nga burimi administrativ. Gjithashtu, të dhënat nga vrojtimit e anketave i nënshtrohen procesit të peshimit, ndërsa vlerësimi nga burimi administrativ është i drejtpërdrejtë.

5. KONKLUZIONE

Në ditët e sotme ekziston nevoja për të kënaqur një kërkesë në rritje të përdoruesve për statistika të një cilësie të mirë, duke bërë të mundur matjen më të shpejtë të fenomeneve të reja. Në të njëjtën kohë, kërkesat e këtyre përdoruesve përpunohen me nevojat që mjedisi i ditëve të sotme kërkon, që barra e përgjegjësisë e vendosur në bizneset dhe qytetarët të zvogëlohet (Laux, Baigorri, & Radermacher, 2009). Prandaj përdorimi dhe kombinimi i të dhënave administrative apo dytësore nga statisticienët shihet në ditët e sotme si domosdoshmëri, por nga ana tjetër shoqërohet me një sërë sfidash. Disa tregues, si ata që u trajtuan më lart, mund të prodhohen

me të dhënat të cilat mund të përftohen nga të dy burimet, ai administrativ dhe statistikor, por ndryshimet thelbësore strukturore mes këtyre dy burimeve, si dhe ndryshimet në metodologjinë e zbatuar sjellin diferenca në vlerësime dhe natyrisht në rezultatet finale të përfuara prej tyre. Këto ndryshime janë të pranishme në pothuajse të gjitha dimensionet e cilësisë si rëndësia, saktësia, afatet kohore, aksesimi, krahasueshmëria dhe koherenca. Për këtë arsye, përdoruesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm në momentin e përdorimit të vlerësimeve nga burime të ndryshme dhe të kuptojnë origjinën e të dhënave, mbledhjen e tyre dhe përdorimin, për të shmangur gabimet dhe keqkuptimet. Kjo i lejon ata të zgjedhin treguesit (Laux, Baigorri, & Radermacher, 2009) që u përshtaten qëllimeve të studimit të tyre më së miri. Më shumë sesa burime konkurrense, të dhënat administrative dhe ato nga vrojtimit duhet të shihen si burime përplotësuese. Ashtu siç shprehen Kapteyn & Ypma (2007), pyetja nëse janë burimet administrative apo vrojtimit ato që tregojnë "të vërtetën", është një pyetje pothuajse filozofike.

BIBLIOGRAFI

Brackstone. (1987). Statistical uses of Administrative Data: Issues and Challenges. Statistical Uses of Administrative Data Proceedings, (fv. 5-26).

Elezi, P. (2018). Raport mbi vlerësimin e cilësisë së burimev administrative. Tirana, Albania.

INSTAT. (2017). Statistikat Afatshkurtra- Raporti i cilësisë. Tirana, Albania: INSTAT.

Jensen, P. (1987). The Quality of Administrative Data From a Statistical Point of View, Some Danish Experience and Considerations. Statistical Uses of Administrative Data Proceedings, (fv. 291-300).

Johnson, B., & Moore, K. (2008). Comparing Administrative and Survey Data. IRS Statistics of Income Working Paper Series.

Kapteyn, & Ypma. (2007). Measurement error and misclassification: A comparison of survey and administrative data. Journal of Labor Economics , 513-551.

Künn, S. (2015). The challenges of linking survey and administrative data. IZA World of Labour , 214.

Laux, R., Baigorri, A., & Radermacher, W. (2009). Building Confidence in the Use of Administrative Data for Statistical Purposes ., (f. 9).

Lessler, & Kalsbeek. (1992). Nonsampling Error in Surveys. New York : John Wiley & Sons.

Penneck, S. (2007). Using Administrative Data for Statistical Purposes . ICES-III. Montreal, Quebec, Canada.

UNECE. (2011). Using Administrative and Secondary Sources for Official Statistics - A Handbook of Principles and Practices, United Nations Economic Commission for Europe. New York and Geneva: UNITED NATIONS.